



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR I EKSPORTEVE

PLANI I INTEGRITETIT AUTORITETIT TE KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

2022-2025

SHTATOR 2023

MIRËNJOHJE

Plani i Integritetit është hartuar nga grupi i punës i ngritur në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë për këtë qëllim dhe me asistencën teknike të ofruar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes e Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS).

Tabela e përmbajtjes

Tabela e përmbajtjes	3
Shkurtime	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
QËLLIMI DHE VIZIONI.....	7
OBJEKTIVAT STRATEGJIKË	7
RREZIQET E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT	8
Përmirësimi i procesit të transparencës dhe llogaridhënies.....	8
PLANI I VEPRIMIT	11
1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut.....	11
2. Fusha e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;.....	14
3. Fusha e inspektimeve.....	16
4. Fusha e menaxhimit financiar.	17

Shkurtime

CIDS	Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, Norvegji
AKSHE	Autoriteti i kontrollit Shtetëror i Eksporteve
DMBNJSH	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
DSIK	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
FA	Forcat e Armatosura
GDI	Indeksi Qeveritar i Integritetit të Mbrojtjes të Transparency International
KKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KDIMDP	Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale
MM	Ministria e Mbrojtjes
MD	Ministria e Drejtësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PI	Plan Integriteti

HYRJE

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të demokracive dhe një shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës. Korrupsioni ndikon shumë në besimin e publikut, dëmton rëndë efektivitetin e institucioneve dhe cenon legjitimitetin demokratik të tyre. Korrupsioni në sektorin e mbrojtjes ka pasoja të rënda, pasi minon aftësitë e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Ai shkakton shpërdorim të burimeve financiare dhe materiale, prokurime të materialeve dhe pajisjeve të papërshtatshme, keqmenaxhim të burimeve njerëzore, barriera administrative për subjektet të cilat operojnë në fushën e transferimit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Në fushën e përgjegjësisë së AKSHE-së, përfshihet licensimi, autorizimi, kontrolli, dhe inspektimi i subjekteve të cilat veprojnë në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, prodhimit, demilitarizimit të armëve, si dhe transferimet ndërkombëtare dhe prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil, artikujt piroteknike, si dhe produktet që mund të përdoren për dënime kapitale apo trajtime çnjerëzore, torture ose denigruese.

Edhe pse fusha e përgjegjësisë së AKSHE-së, ka lidhje me çështjet e sigurisë, dhe subjektet e përfshira kryesisht ka një nivel të lartë ndërgjegjësimi dhe eksperience, masat që duhet të ndërmerren kundër korrupsionit duhet të adresojnë çështje të ndryshme që përfshijnë licensimet, inspektimet, kontrollet dhe transparencën.

Republika e Shqipërisë nëpërmjet AKSHE-së, ka në fokus zbatimin e normave ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, si dhe kontrollin mbi përdorimin final të produkteve të cilat mund të devijohen në aktorë të paautorizuar, që mund të kryejnë aktivitete të kundraligjshme ose terroriste.

Kontrolli në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të parandalimit të transferimit të armëve drejt aktorëve të paligjshëm vjen në kuadër të normave ndërkombëtare dhe të dokumentave strategjikë të Republikës së Shqipërisë ku më kryesorët janë;

- Rezoluta 1540 e Kombeve të Bashkuara
- Traktati i Tregtisë së Armëve
- Strategjia Kombëtare e mos-përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe plani i veprimit
- Strategjia Kombëtare e kontrollit të armëve të vogla e të lehta

AKSHE-ja ka ndërmarrë një sërë masash, duke forcuar sistemin e transparencës së institucionit. Në faqen zyrtare të AKSHE-së është publikuar modeli i ri i programit të transparencës, i cili përditësohet rregullisht me synim njohjen e publikut me më shumë informacion, si dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Gjithashtu, një rubrikë e veçantë i kushtohet dokumentacionit lidhur me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, duke publikuar jo vetëm aktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit, por dhe raportet e transparencës që hartohen pas konsultimit publik të çdo akti.

Megjithatë, përpjekjet në fushën e integritetit kanë rezultuar më së shumti nga zbatimi i politikave në nivel kombëtar, dhe AKSHE-ja nuk ka pasur një dokument të veçantë me fokus adresimin e rreziqeve të korrupsionit. AKSHE-ja është institucion kontribues në Strategjinë ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe raporton rregullisht pranë Ministrisë së Mbrojtjes mbi masat e ndërmarra.

Plani i Integritetit 2023-2025 është dokumenti i parë i hartuar nga AKSHE-ja për të kontribuar në parandalimin dhe luftën kundër rreziqeve të mundshme të korrupsionit në këtë institucion. Plani ka në fokus këtë sektor dhe synon të shërbejë edhe si mekanizëm për orientimin e masave për forcimin e integritetit dhe adresimin e rreziqeve të korrupsionit në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Plani ka identifikuar rreziqe të integritetit në fushat e mëposhtme:

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut;
2. Fushën e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;
3. Fushën e inspektimeve;
4. Fusha e menaxhimit financiar;

Plani i Integritetit parashikon të prodhojë një nxitje re dhe shtysë të mëtejshme të përpjekjeve të deritanishme, duke gjeneruar aktivitete dhe praktika të reja të cilat synojnë përmirësimin e mekanizmave të menaxhimit në tërësi.

Duke marrë parasysh rëndësinë e tij, Plani i Integritetit parashikon edhe krijimin e mekanizmit të zbatimit dhe të monitorimit dhe vlerësimit për të matur progresin e arritur.

METODOLOGJIA

Plani është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, të miratuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Ndërtimit të Integritetit të NATO-s dhe të Indeksit Qeveritar të Integritetit të Mbrojtjes të Transparency International dhe të Planit të Integritetit të ministrisë së Mbrojtjes

Zhvillimi i Planit të Integritetit kaloi nëpër disa faza, duke filluar me (1) krijimin e procesit përmes ngritjes së grupit të punës, i përbërë nga zyrtarë të drejtorive të AKSHE-së dhe me drejtimin e Drejtorit të Drejtorisë së Legjislacionit dhe Licensimit, Kryetarit të institucionit, (2) kryerjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe integritetit në sektorë të veçantë dhe hartimin e matricës së risqeve, (3) hartimin e masave dhe aktiviteteve për adresimin e risqeve. Procesi përfundoi me konsultimin e planit, miratimin e tij zyrtar nga Kryetari i Institucionit dhe publikimin e tij.

Zhvillimi dhe hartimi i Planit të Integritetit është kryer nga grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit të AKSHE-së, (i përbërë nga përfaqësues nga Drejtoria e Legjislacionit dhe Licensave si dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës), gjatë periudhës Dhjetor 2022 - Gusht 2023.

Hartimit i Planit të Integritetit është kryer me asistencën teknike të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, i Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS).

QËLLIMI DHE VIZIONI

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit të AKSHE 2023-202 është të forcojë integritetin dhe kulturën kundër korrupsionit në këtë sektor.

Vizioni i këtij plani është që kjo fushë (transferimi i mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, lëndët plasëse, artikujt piroteknike) ruan integritetin dhe refuzon korrupsionin, duke institucionalizuar standardet dhe parimet më të larta të mirëqeverisjes.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Për realizimin e qëllimit dhe vizionit, Plani i Integritetit i AKSHE-së vendos katër objektiva strategjikë të cilët synohet të arrihen përmes zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara në këtë plan. Gjithashtu, objektivat strategjikë kanë shërbyer si orientim për të identifikuar aktivitete dhe masa të përshtatshme dhe treguesit për matjen e tyre.

Objektivat strategjikë reflektojnë gjithashtu objektivat e politikës së mbrojtjes (Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes), Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020 - 2024 të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe objektivat e Strategjisë Ndërsektorale për Luftën Kundër Korrupsionit.

Nisur nga sa më sipër, objektivat strategjikë të Planit të Integritetit të AKSHE-së 2022 - 2025 janë:

1. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;
2. Përmirësimi i procedurave në fushën e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;
3. Përmirësimi i procedurave në fushën e inspektimeve
4. Përmirësimi i sistemeve të prokurimeve;

RREZIQET E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT

Përmirësimi i procesit të transparencës dhe llogaridhënies

Transperanca dhe informimi është një element thelbësor, ku subjektet dhe publiku duhet të njihen me procedura te sakta të cilat të jenë publike, ndryshime legjislacioni dhe informim mbi aktivitetet e institucionit.

Statusi aktual

Risqet në fushën procesit të transparencës dhe logaridhënies paraqitet i lartë, kryesisht për shkak të mungesës së një politike antikorrupsion, mungesën e vlerësimeve periodike të rreziqeve të integritetit, Këto mangësi janë reflektuar në mungesën e komunikimit publik mbi integritetin në institucionet dhe përfshirje të ulët të shoqërisë civile ose organizatave joqeveritare në proceset e mbikëqyrjes së jashtme publike në çështjet e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të legjislacionit. MM-ja, përfshirë dhe AKSHE-në nuk ka hartuar ndonjë dokument, përveç zbatimit të masave që rrjedhin nga strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit. Në kuadër të Planit të Integritetit, AKSHE-ja-ja do ta adresojë këtë mangësi. Me miratimin e Planit të Integritetit, identifikimi i rreziqeve të korrupsionit do të kryhet periodikisht..

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies”*

Përmirësimi i procedurave në fushën e lëshimit të licensave dhe autorizimeve

Duke qenë se fusha e veprimtarisë së AKSHE-së, ka të bëjë me mallra strategjike dhe procedurat e Licensimit të Subjekteve private dhe shtetërore në këtë fushë ka tendencën për të patur sa më shumë garanci për eliminimin e rrisqeve të cilat mund të vijnë në lidhje me sigurinë kombëtare ose ndërkombëtare. Nga ana tjetër përfshirja e disa institucioneve të ndryshme në këtë proces kërkon një koordinim më të lartë dhe më të shpejtë. Pavarësisht se përfshirja e disa insitucioneve është e domosdoshme kjo rrit probabilitetin e rrisikut të korrupsionit.

Statusi aktual

Procesi i Licensimit të AKSHE-së, bazohet mbi një kuadër ligjor dhe institucional i cili është i miratuar. Për të shmangur korrupsionin, por dhe sjelljet joetike që mund të ndodhin gjatë fazave të ndryshme të procesit të licensimit, është e nevojshme dhe e domosdoshme që niveli i transparencës të jetë maksimal. Procedurat duhet të jenë të qarta, publike si dhe transparente,

miratimi ose refuzimi i licensave autorizimeve të bëhet me vendime të arsyetuara. Gjithashtu sistemet online të licensimit që nderveprojnë me institucionet e tjera në kohë reale duhet të ngrihen dhe të jenë funksionale.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të licensimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”*

Përmirësimi i procedurave në fushën e inspektimeve

Rreziqet e integritetit mund të hasen në çdo fazë të kontrollit dhe inspektimit të ndërmarrë nga AKSHE-ja. Planifikimi paraprak i inspektimeve vjetore dhe periodike si dhe përcaktimi i qartë i procedurave për inspektime të paplanifikuara nga ana e autoritetit ul probabilitetin e risqeve të korrupsionit. Procesi i inspektimit dhe kontrollit duhet të jetë i bazuar në metodologji por edhe në mjetë elektronike. Duke qenë se rreziqet e integritetit ekzistojnë gjatë gjithë procesit të inspektimit, është e nevojshme që të aplikohet një metodë gjithëpërfshirëse për të parandaluar korrupsionin dhe për të reduktuar tërësisht rreziqet e integritetit.

Statusi aktual

AKSHE-ja kryen inspektime të rregullta në subjektet e licensuara për zbatueshmërinë e detyrimeve të përcaktuara në legjislacion dhe në licensën apo autorizimin e marrë. Inspektimet kryen në pika doganore ose pranë zyrave dhe magazinave të subjektit. Mungesa e një sistemi raportimi online dhe ndërveprueshmërie edhe me institucionet e tjera si doganat rrit risqet e integritetit.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”*

Përmirësimi i sistemeve të prokurimeve

Prokurimet publike janë një nga fushat ku probabiliteti për korrupsion është i lartë. Lufta kundër korrupsionit dhe forcimi i integritetit në procesin e prokurimit publik nuk mund të realizohen vetëm nëpërmjet miratimit të një kuadri ligjor dhe rregullator të avancuar. Për të shmangur korrupsionin, por dhe sjelljet joetike që mund të ndodhin gjatë fazave të ndryshme të procesit të prokurimit publik, është e nevojshme dhe e domosdoshme që niveli i transparencës të jetë maksimal. Përveç forcimit të transparencës, një element tjetër i rëndësishëm për prokurimet publike është mbikëqyrja dhe kontrolli i rregullt me qëllim garantimin e një procesi të drejtë.

Punonjësit e përfshirë në proceset e prokurimeve publike janë të ekspozuar ndaj një niveli të lartë risku, duke filluar që nga procesi i draftimit të specifikimeve teknike e deri tek kriteret për pjesëmarrje në tendera.

Statusi aktual

Në fushën e prokurimeve publike, pavarësisht se një gamë e madhe dokumentesh publikohen në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, AKSHE-ja duhet të përmirësojë nivelin e transparencës. Referuar ligjit për të drejtën e informimit, dokumentacioni mbi procesin e prokurimeve publike duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm në programin e transparencës. Regjistri i parashikimeve dhe regjistri i realizimeve duhet të jetë transparent dhe i përditësuar. Riske të tjera që mund të shfaqen në fushën e menaxhimit financiar mund të jenë dhe moszbatimi i kontratave të lidhura sipas grafikut të parashikuar, duke krijuar në këtë mënyrë hendeqe financiare.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”*

PLANI I VEPRIMIT

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut;
2. Fushën e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;
3. Fushën e inspektimeve;
4. Fusha e menaxhimit financiar;

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është “Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies”

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETET	BURIMET
1. Infomacion jo i plotë dhe i natyrës teknike mbi procedurat dhe afatet e licensimit.	Publikimi i procedurave të licensimit, afatet dhe detyrimet e subjekteve në faqen e internetit në mënyrë sa më të thjeshtë dhe lëhtësisht të kuptueshme nga publiku.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Janar 2023	Përmirësimi i faqes së internetit si dhe kontraktimi i shërbimit TIK.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave

2. Mungesa e aktiviteve informuese me subjektet në tryeza të përbashkëta.	Organizimi i një aktiviteti / tryeze informative me subjektet e përfshira në fushën e përgjegjësisë së AKSHE-së	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Tetor 2024	Ekspertet e BE-se, EXBS, ambientet dhe krijimi i agendes	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës dhe Programet e Asistencës së BE-se dhe EXBS Departamenti i Shtetit
3. Mungesa e raporteve kombëtare për vitet në vijimësi për transferimet e mallrave strategjike, hedhja e të dhënave të regjistrit të subjekteve të licensuara, si dhe të aktiviteve të AKSHE-së për interes publik dhe mediatik.	Përditësimi dhe publikimi në faqen Web të raporteve kombëtare si dhe të regjistrit.	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave	Maj 2024	Strukturimi i raporteve duke eliminuar pjesët konfidenciale dhe sekret tregtar, publikimi i tyre në faqen Web	Drejtoria e legjislacionit dhe Licencave
4. Mungesa e trajnimeve për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.	Hartimi i një kurrikule trajnimi dhe trajnimi i stafeve të drejtorive që hartojnë akte ligjore dhe nënligjore	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Prill 2024	Trajnim i vazhdueshëm i koordinators të njoftimit dhe konsultimit publik.	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik me mbështetjen e CIDS-së

	lidhur me procesin e konsultimit publik.				
5. Mungesa e trajnimit të rregullt në lidhje me antikorrupsionin dhe integritetin për të gjithë personelin.	Përfshirja e trajnimit për antikorrupsionin dhe integritetin, në planin vjetor të trajnimeve në bashkëpunim me MM	Drejtoria Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM dhe e legjislacionit dhe Licencave	Qershor 2024	Hartimi i një kurrikule trajnimi antikorrupsion/integritet.	Stafi i MM-së, Stafi i AKSHE-së me mbështetjen e CIDS-së

2. Fusha e lëshimit të licensave dhe autorizimeve;

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të licensimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”*

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETET	BURIMET
1. Barra e larte administrative.	Zhvillimi i procesit të derregullimit me qëllim uljen e barrës administrative dhe qarkullimin e dokumentave online.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Dhjetor 2024	Rishikimi i procedurave ekzistuese. Evidentimi i dokumentave që rrisin barrën administrative për aplikime. Evidentimi i dokumentacionit i cili mund të merret nëpërmjet platformave ndërvepruese	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave
2. Përmirësimi i simeve online për aplikimet, duke ulur kontaktin me subjektet aplikuese.	Ngritja e nje sistemi online për aplikimet për licensa/autorizime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Dhjetor 2024	Krijimi i softëare elektorik për e-licenca. Trajnimi i punonjësëve dhe subjekteve.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Programet e Asistences se BE-se dhe EXBS Departamenti i Shtetit

3. Lëshimi i licensave / autorizimeve në afatet e përcaktuara në legjislacion.	Krijimin e sistemeve elektronike te monitorimit te afateve	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Dhjetor 2024	Krijimi i softëare elektorik për e-licenca. Trajnimi i punonjësëve dhe subjekteve.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Programet e Asistences se BE-se dhe EXBS Departamenti i Shtetit
4. Mungesa e një plani vjetor trajnimesh i cili buron nga vlerësimi i nevojave për trajnime në fushën e procedurave të licensimit.	Hartimi i planit vjetor për trajnime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës	Qershor 2024	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave finalizon planin vjetor për trajnime.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës

3. Fusha e inspektimeve.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve procedurave transparente dhe ofrimin e shërbime online”*

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETET	BURIMET
1. Mungesa e Planit vjetor të inspektimeve.	Hartimi i Planit vjetor të inspektimeve dhe metodologjisë për inspektime rastësore.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Dhjetor 2024	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës finalizon planin vjetor për trajnime.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës
2. Mungesa e trajnimeve mbi procesin e inspektimit në subjekte dhe pika doganore.	Përfshirja e trajnimeve të inspektorëve mbi procedurat e inspektimit.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës	Dhjetor 2024	Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime specifike në lidhje me procedurat e inspektimit.	Drejtoria Inspektimit dhe Analziës
3. Përmirësimi i sistemit të raportimit nëpërmjet mjeteve elektronike me qëllim uljen e barrës inspektuese dhe numrit të inspektimeve.	Krijimin e sistemeve elektronike të raportimeve nga subjektet	Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës, Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave	Dhjetor 2024	Krijimi i softëareve elektronik për raportimet e subjekteve.	Drejtoria e Legjislacionit dhe Licencave, Drejtoria e Inspektimit dhe Analizës Programet e Asistencës së BE-së dhe EXBS Departamenti i Shtetit

4. Fusha e menaxhimit financiar.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: *“Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”*

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETI	BURIMET
1. Mungesa e trajnimeve për koordinatorin e riskut.	Pjesëmarrja në trajnime e koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut	Prill 2024	Trajnime të koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut
2. Mungesa e rregullave të veçanta për mirëadministrimin e aseteve dhe materialeve.	Përfshirja e rregullave për rotacionin e stafit, në rregulloren e brendshme të institucionit.	Drejtorja e Legjislacionit dhe Licencave	Prill 2024	Hartimi i rregullave të posaçme për rotacionin e stafit gjatë procedurat me risk të tilla, si prokurimet publike.	Drejtorja e Legjislacionit dhe Licencave
3. Mungesa e transparencës për të gjithë dokumentacionin e hartuar për procesin e prokurimit publik.	Përditësimi i programit të transparencës.	Drejtorja e Inspektimit dhe Analizës, Sektori i Financës dhe Burimeve mbështetëse	Shkurt 2024	Publikimi në programin e transparencës i regjistrit të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të prokurimeve publike.	Drejtorja e Inspektimit dhe Analizës Sektori i Financës dhe burimeve mbështetëse